



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
DREJTORIA E INTEGRIMIT EUROPIAN DHE MARDHËNIEVE ME PUBLIKUN

Nr.1077 prot

Roskovec, më 31.12. 2024

SHPALLJE

Bashkia Roskovec në bazë të ligjit 139 datë 17.12.2015 "Për Vetqeverisjen Vendore" do të krijojë Këshillin Ekonomik, si një organ këshillimor që jep mendime, rekomandime dhe iniciacion iniciativa për cështjet që kanë të bëjnë me gjendjen e ekonomisë dhe masat për përmirsimin e zhvillimit ekonomik lokal.

Veprimtaritë e Këshillit Ekonomik janë:

1. koordinon punën e organeve të vetëqeverisjes lokale me subjektet afariste;
2. merr pjesë në hartimin e strategjive dhe akteve të tjera që përcaktojnë qëllimet dhe masat për përmirsimin e zhvillimit ekonomik lokal;
3. jep rekomandime gjatë përgatitjes së buxhetit të Bashkisë së Roskovec-it, në pjesën që ka të bëjë me mjetet e destinuara për nxitjen e aktivitetave ekonomike;
4. monitoron dhe merr pjesë në aktivitete që synojnë promovimin e Bashkisë së Roskovec-it dhe potencialin e saj ekonomik;
5. organizon punën e bordit, si organe të ngushta profesionale për veprimtari ekonomike, të cilat kanë rol konsultativ për përmirsimin e veprimtarisë ekonomike;
6. fillon iniciativa për përmirsimin e mjedisit të biznesit dhe heqjen e barrierave administrative;
7. bashkëpunon me organe të njëjta ose të ngjashme të bashkive dhe qyteteve të tjera, organe dhe institucionë shtetërore për çështje të shkëmbimit të përbashkët të përvojave dhe forcimit të bashkëpunimit ekonomik;
8. iniciacion iniciativa për përmirsimin e bashkëpunimit të autoritetave, institucioneve, shërbimeve dhe kompanive publike të themeluara nga Bashkia e Roskovec-it, subjekteve ekonomike organizatave dhe institucioneve në zonën e Bashkisë së Roskovec-it;
9. shqyrton çështje të tjera që përfshijnë masa dhe aktivitete për krijimin e kushteve më të mira për ekonominë.

Kriteret për anëtarësim janë:

Këshilli Ekonomik Vendor përbëhet nga anëtarë që përfaqësojnë sektorë të ndryshëm të ekonomisë, duke përfshirë:

1. Përfaqësues të qeverisë lokale - Kryetarë ose përfaqësues të bashkisë
2. Përfaqësues të bizneseve lokale - Përfaqësues të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, si dhe kompanive më të mëdha që operojnë në zonë.
3. Përfaqësues të shoqatave ekonomike dhe tregtare - Shoqata të biznesit, dhoma tregtie, ose shoqata të tjera që mbrojnë interesat e komunitetit të biznesit.
4. Përfaqësues të sindikatave - Kryetarë ose anëtarë të sindikatave që përfaqësojnë punonjësit e rajonit.
5. Akademikë ose ekspertë ekonomikë - Specialistë nga universitetet ose institucione kërkimore që jepin mendime profesionale dhe analizojnë politikat e zhvillimit ekonomik.
6. Përfaqësues të organizatave joqeveritare - OJQ që merren me çështje ekonomike, zhvillim rajonal dhe të drejtat e punëtorëve.
7. Përfaqësues të sektorit bujqësor - Për Bashkinë Roskovec, bujqësia është sektori kryesor ekonomik.

Bashkia Roskovec fton të gjithë subjektet ose përfaqësues të tyre, që duan të bëhen pjesë e Këshillit Ekonomik të dorëzojnë dokumentacionet.

1. Shprehje interesi
2. Dokument zyrtar i regjistrimit të biznesit
3. Fotokopje të kartës së identitetit
4. Dëshmi penaliteti

Afat për dorëzimin e dokumentacioneve është data 16.01.2025, ora 16:00

Ju faleminderit!

